



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1089/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, ashtu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjorbë në shumë prej 2,500.00 (dymjë e pesqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

Me datën 19.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me të cilën ka pretenduar se deputeti Nezir Çoçaj, nga radhët e subjektit politik PDK, ditën e zgjedhjeve, me datë 19.11.2017, në ora 08:58 minuta paradite, përmes rrjetit social facebook ka bërë thirrje për ta votuar kandidatin e PDK-së, Shaqir Totaj. Më tej parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime bien ndesh me nenin 36.1 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në përgjigje në ankesë të datës 21.11.2017, ka theksuar se, ankesa është e pabazuar për arsye se PDK nuk mund të jetë përgjegjëse për veprimet nëpërmjet rrjetëve sociale të anëtarëve të vet. Përgjegjësia bie vetëm nëse ka veprime fizike në masë ose edhe para masës dhe nuk mund ti kontrollojnë votuesit qofshin ata me pozita të caktuara apo jo.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 të LZP-së gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës shihet se deputeti Nezir Çoçaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e tij social facebook ka bërë thirrje për ta votuar kandidatin e PDK-së, Shaqir Totaj kandidat për kryetar të Kuvendit Komunal në Prizren, ku me këtë veprim ka shkelur Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatet e tyre duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Ndërsa, lidhur me pretendimet e subjektit politik PDK se nuk mund të jetë përgjegjëse për veprimet nëpërmjet rrjetëve sociale të anëtarëve të vet, Paneli konstaton se këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që në bazë të nenit 32 par 3 dhe 4 të LZP-së subjektet politike i informojnë anëtarët, mbështetësit e tyre dhe kandidatët rreth dispozitave të këtij kodi, dhe duhet të ndermarin të gjitha hapat e nevojshme për ti parandaluar nga shkelja e këtij kodi.

Andaj, PZAP-i duke marr parasysh shkeljet e gjetura, bazuar në nenin 36 të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohej bërja fushatë në çfarëdo mënyre, andaj subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është përgjegjëse për shkeljet e gjetura të thyerjes së heshtjes zgjedhore në bazë të nenit 32.5 të LZP-së ku përcaktohet se “subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët mbështetësit e tyre”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së PDK-ja, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara dhe e njëjta nuk ka ofruar prova sipas nenit 32.6 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL Anr.1089/2017 më datë 21.11.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
**Hasan Shala**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.